

2.2 REGJISTRIMET BIBLIOGRAFIKE

2.2.1 Krijimi i regjistrimit të ri bibliografik

Para krijimit të regjistrimit të ri bibliografik duhet të siguroheni, që regjistrimi për të njëjtin burim bibliografik nuk ekziston në bazën lokale të të dhënave ose në COBIB. Në këtë mënyrë nuk do të bëni dublikatë.

Regjistrimet e krijuara ruhen njëkohësisht në COBIB dhe në bazën lokale të të dhënave.

2.2.2 Redaktimi i regjistrimit bibliografik

Në modulën COBISS3/Katalogimi regjistrimet mund të redaktohen njëkohësisht në COBIB dhe në bazën lokale të të dhënave, ose vetëm në COBIB.

Regjistrimet redaktohen vetëm në bazat lokale të të dhënave në rastet kur para përdorimit të programit COBISS3/Katalogimi është përdorur programi COBISS2/Katalogimi. Në këtë mënyrë, me procedurë të veçantë mund të redaktohen vetëm regjistrimet, të cilat janë krijuar në COBISS2/Katalogimi dhe nuk janë redaktuar ende në COBISS3/Katalogimi (shih kap. 8.4.2). Për të patur efektshmëri dhe cilësi në sistemin COBISS, rekomandohet, që regjistrimet ekzistuese të redaktohen ose të plotësohen edhe në COBIB dhe jo vetëm në bazat lokale të të dhënave.

Regjistrimi redaktohet vetëm në COBIB në rastin kur biblioteka nuk i ruan materialet dhe kur regjistrimin nuk dëshiron ta kopjoj në bazën lokale të të dhënave (shih kap. 8.4.3).

Në të njëjtën kohë regjistrimin mund ta redaktoj vetëm një katalogues brenda sistemit.

Në bazat lokale të të dhënave të bibliotekave të veçanta mund të ekzistojnë regjistrime, të nuk ndodhen në COBIB. Këto janë regjistrime bibliografike lokale, të krijuara përmes konvertimit nga sistemi, të cilin biblioteka e ka përdorur para përfshirjes në sistemin COBISS.

Rekomandohet, që regjistrimet bibliografike lokale të transferohen sa më shpejt në COBIB (shih kap. 8.6).